# Crown Financial Ministries paraqet:

## Seminari: "Biznes Gomari"*

**Data: E mërkurë, 17 qershor, ora 18-21:00 .**
**Vendi: Instituti "Jeta e Re"** (Ndertesa Jeshile mprapa TVSH)

*Përshkrimi: Tradicionalisht shumë të krishterë kanë bërë një dallim midis thirrjeve shpirtërore dhe atyre laike në jetë. Biznesi konsiderohet pothuajse unanimisht si një veprimtari laike dhe disi inferiore ndaj "shërbesës" shpirtërore. Seminari "Biznes Gomari" do të paraqesë idenë se thirrja e Perëndisë për dikë është gjithmonë shpirtërore, pavarësisht nga konteksti në të cilin ndodh. Ky seminar do të sigurojë një pamje të përgjithshme të urtësisë që Bibla përmban në lidhje me drejtimin e biznesit në mënyrën që dëshiron Perëndia, duke përfshirë edhe tema si zotërimi/pronësia, qëllimi, financat, integriteti dhe burimet njerëzore.*

*Ky është një seminar që bëhet në mbrëmje për këdo që është i përfshirë në biznes, që ka interes në biznes ose ka miq në biznes të cilët dëshiron t'i ftojë. Do të ketë edhe një koktej të vogël.*

**Ka pasur emrin: "Çfarë Thotë Bibla Për Biznes"*

*"Biznes Gomari" sponsorizohet nga Iniciativa Sotmeria, një shërbesë të Institutit Jeta e Re dhe në bashkëpunim me Unionin e Drejtuesve Shqiptarë.*



# Kush eshte Piter Brisko

Piter Brisko eshte anglez, i datelindjes 1950. Ai ka studjuar per menaxhim ne degen e Kimise Industriale ne Universitetin Lafboro ne Angli. U transferua ne Hollande me 1974 per te ngritur nje filiale te kompanise ku punonte ne te cilen mbajti postin e Drejtorit Ekzekutiv deri ne vitin 1986.

Ne vitet 1887-1989 Piteri ishte Drejtor Ekzekutiv i Komiteteve te Biznesmeneve te Krishtere (CBMC ne Hollande). Veprimtarite tipike te CBMC jane mengjeze lutjesh ne aktivitete te ndryshme deri edhe ne parlamente, veprimtari promocionale per te bere te njohur prezencen e Jezu Krishtit ne boten e biznesit, trajnime per lidershipin e krishtere etj.

Ne 1990, Piteri krijoji Synthesys nje kompani konsultuese te profilizuar per aspekte menaxheriale ne industrine kimike.

Kur ra Muri i Berlinit dhe u hapen mundesite per biznes ne Europen Lindore, Piteri zhvilloi idene e Europartnereve, nje levizje dedikuar biznesmeneve dhe profesionisteve te ndryshem nga Europa Lindore, e cila synon perqafimin prej tyre te Jezu Krishtit dhe te mesimeve te Tij ne biznes dhe ne jeten profesionale. Ne vitin 2002 kjo levizje ishte perhapur ne 28 vende te Europes me rreth 500 grupe lokale dhe rreth 5000 aktiviste. Tani Piteri vazhdon te aktivizohet si anetar i Bordit Drejtues te kesaj levizjeje.

Ne vitin 2002, Piteri mori detyren si Drejtor Ekzekutiv i Operacioneve Kozmike me zyra ne Hjuston (SHBA), Ketvejk (Hollande) dhe Bremen (Gjermani) ne sherbim te Institucioneve Europiane Kozmike. Piteri udhehiqte nje skuader profesionistesh prej 50 vetesh te perbere nga mjeke, biologe, inxhiniere, fizikane dhe specialiste biznesi. Dy projekte kryesore ne te cilat ishte angazhuar kompania e tij jane Sistemi i Sateliteve Galileo dhe Udhetimi ne planetin Mars Aurora.

Ne 2007 ai u terhoq perseri nga biznesi per tu marre me sherbesen Crown Financial Ministries dhe Crown Companies ne Europe.

Piteri banon ne qytetin Leiden, ku eshte anetar i Kishes Baptiste te Leidenit dhe pjestar i Bordit te te Moshuarve. Eshte martuar qe ne 1972 me hollandezen Didie dhe kane tri vajza te rritura.



Folësi ynë:
Piter Brisko